

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitim skema ujitëse “Rezervuari Bregu i Lendinave, Çërravë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndertimi per diga, kanale, kanale te ujitjes dhe ujesjelles 45247000-0; Punime ndertimi per diga 45247210-2; Punime ndertimi per rezervuare 45247270-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 783 857, 36 (pesë milion e shtateqind e tetedhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë presje tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”te ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Pogradec**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formulari i ofertës sipas Shtojcë 1

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”te ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26 ‘Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik te ndryshuar:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. ku përcaktohet se: " *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar*"

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është "E Hapur e thjeshtuar – Punë Publike - me mjete elektronike", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 55, pika 4, gërma të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar ku përcaktohet se: *Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave."*

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (40%) është brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohet. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këtë procedure është gjykuar që vlera e xhiros së kërkuar të jete minimalisht sa vlera e parashikuar e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar .

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të Nenit 88, pika 3 e VKM 285/2021, parashikon se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”

Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-

së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

Pra në rastet e BOE, dokumentacioni i kërkuar për të vertetuar përvojën e mëparshme si kontrata e bashkëpunimit, disponohen nga çdo OE në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që ka çdo shoqëri në dosjen e saj në rastin kur ka qene në atë status, e për rrjedhojë nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe nuk sjelle asnjë kufizim të pjesmarrjes së OE në procedurën e prokurimit në fjalë.

Kriteret teknike janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës inxhinier, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P - 1A Punime gërmimi në tokë.
- NP - 5A Punime nentokesore, ura e vepra arti
- N.P – 6A Diga dhe tunele hidroteknike
- NP – 7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë:

N.S- 9 A Punime strukturore speciale

N.S - 18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë

19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licensave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

NP-1 A Punime gjurmimi në tokë

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjurmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat i skemes ujëtare që do të ndërtohet. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjurmimit.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NP - 5A Punime nëntokësore, ura e vepra arti

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, Punime nëntokësore Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushtet që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

Të tilla punime përfshihen në zërat e preventivit si punimet e mureve mbajtëse të skemes ujëtare që do të ndërtohet. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P – 6 Diga dhe tunele hidroteknike

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 Diga dhe tunele hidroteknike. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujën e

grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes. Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali

Preventivi e justifikon kete ze dhe kategori licence pranda kerkohet dhe nga AK. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S- 9 A Punime strukturore speciale

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 Punime strukturore speciale Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratoriale nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizim dhe konsolidimin e terreneve.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S - 18 A Punime topogjeodezike

Punime të tilla përfshijnë zbatimin e riveimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe dokumentacionin e pronësisë së objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objektit në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.

Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontrates. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier hidroteknik 1 (një)

I cili, duhet të jetë në Listëpagesa të pakten për muajin e fundit nga hapja e ofertave si dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë, për të cilin duhet të paraqitet:

- kontratë pune e vlefshme

- diploma përkatëse.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" te ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te dryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierin në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si inxhinieri hidroteknik, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Topograf

I cili, duhet të jetë në Listëpagesa të pakten për muajin e fundit nga hapja e ofertave si dhe të figurojnë në licensën e shoqërisë, për të cilin duhet të paraqitet:

- kontratë pune e vlefshme
- diploma përkatëse.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", I ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Inxhinieri topograf kërkohet pasi ndihmon në matjet e sakta që kërkohen për realizimin me sukses të kontrates.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të kualifikuar dhe të thjeshtë, si më poshtë:

-Specialist Ndërtimi 2 (dy)

-Pllakashtrues 7 (shtatë)

-Punëtorë 5 (pesë)

-Hidraulik 1 (një)

-Elektriçist 1 (një)

-Manovrator 2 (dy)

-Drejtues Mjeti 2 (dy)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit, ndërsa për shofere dhe manovratorë, kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen me kontrate pune, së bashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Për punonjësit e kualifikuar të paraqitet Çertifikatat/diplomat/dëshmi të leshuara nga institucione publike /private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH”, I ndryshuar.

Për teknikun e ndërtimit do të pranohet diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.

Për shoferet të paraqitet leje drejtimi e vlefshme. Për manovratorët dëshmitë e aftësisë profesionale nga DPSHTRR.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të leshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtori i ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të skemes ujtesë dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit.

-Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, janë kërkuar 2 (dy) specialist ndërtimi Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e madh të punimeve dhe grafikun e punimeve.

-Për realizimin e punimeve hidraulike në objekt është kërkuar 1 (një) hidraulik, i cili merret me ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujitjes, të sistemeve hidraulike të objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme. Ai monton, instalon, riparon dhe mirëmban pajisjet dhe aksesoret për ujë, gaz, kullim, kanalizim, pajisje të

sistemeve të ngrohje- ftohjes, pajisje pneumatike etj. Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punës në këto objekt prokurimi.

-Për zbatimin e punimeve elektrike, të tilla si punimet për kuadrot elektrikë, sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar të paktën 1 (një) elektrikiste. Ky punonjes i kualifikuar, merret me montim, instalim dhe riparim të sistemit elektrik në objekte të ndryshme etj. Elektricisti monton, instalon, riparon dhe mirëmban makineri dhe pajisjeve elektrike civile dhe industrial. Punimet elektrike zënë një vend të rëndësishëm në prevetivin total të punimeve, si nga pikëpamja e sasisë, ashtu edhe të vlerave.

-Shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) instalon, mirëmban dhe riparon dyshemene, muret ose sipërfaqet e tjera me pllaka. Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin e një pjese të konsiderueshme të kanalit të skemes së ujitjes me pllaka. Këto punime në preventiv pëfshijnë sipërfaqe të mëdha, për këtë arsye, për realizimin e këtyre zerave AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër minimal prej 7 (shtate) pllakashtruesish. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët do të punohet paralelisht.

- AK ka kërkuar dy manovrator për përdorimin e makinerive të rënde që kërkohen për zbatimin me skusese të kontartes.

-AK ka kërkuar dhe dy shofere ose persona me leje drejtimi pasi objekti ka nevojë për dy persona që drejtojnë mjetet që nevojiten për realizimin e kësaj kontrate.

Percaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe vëllimet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023. *Bazuar në kriteret elementarë dhe strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).* Numri i punonjesve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për "Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë", ose ekuivalente, e dhënë nga një organizim i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" I ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, Ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 20 (njëzet) persona për muajin e fundit nga hapja e ofertave, e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit nga hapja e ofertave.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit nga hapja e ofertave.

Shënim: *Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për 1 (një) muaj të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listëpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përqipet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shpirtore e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 24 persona, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës*

është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Kete perlllogaritje si nevoje e transparencies ndaj ofertuesve po e paraqesim te detajuar si me poshte:

NR	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ore pune/ njesi	ore pune total
) REHABILITIM SKEMA UJITISE					
REZERVUARI BREGU I LENDINAVE +					
Shkarkuesi katastrofik					
1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme me krahe, me seksion deri 0.75 m2	m2	56	0.06	3.36
2	Strukture monolit betoni C16/20 i)per dyshemene e pusetave(2x2x0.2)x2 ; j)muret e	m2	13.6	12.80	174.08
		5.44			
3	Struktura te holla monolit betoni C16/20 (brez betoni)	m3	1.05	12.80	13.44
Rehabilitim Rezervuari					
1	F.V. tuba celiku φ>200 te pa izoluar per ujesjellsa te jashtem	ton	1.9	53.00	100.70
2	Germim dheu me krahe ne seksion te lire ne toke te bute kat.I-II pa hedhje (per bazamentin e pusetave hyrje dalje 4 x	m3	4	3.80	15.20
3	Strukture monolit betoni C16/20 i)per dyshemene e pusetave(2x2x0.2)x2 ; j)muret e	m3	5.92	12.80	75.78
4	F.V saraqineske celiku me flanaxha Pn25 bar φ 300mm	cope	1	14.00	14.00
5	Mbushje rrafshim ngjeshje me tokmak elektrik cdo 30 cm toke te bute	m3	1800	0.84	1512.00
6	Rafshim e ngjeshje dheu ne trup dige me cilindër me dhembe (me shtresa 40 cm)	m3	1800	0.03	54.00
7	F.V. skare hekur beton per puseten e hyrjes (shkalla hekur 20)	ton	1.2	42.00	50.40

8	Germim dheu me ekskavator krahegjate,per mbushje dige me 2 hedhje +25% koef. I shkrifmerise	m3	4805	0.01	60.06
9	Germim dheu me ekskavator krahegjate,per shkallezim te skarpaceve	m3	920	0.01	11.50
10	Skarifikim dheu t=10-20cm ne skarpace me ekskavator me kove 0.5m3	m3	345		
Rehabilitim Kanali Ujites					
1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme me krahe , me seksion deri 0.75 m2	m3	329.14	0.06	19.75
2	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak,	m3	300.00		
3	FV tubo betoni ϕ 600mm	ml	25.00	3.43	85.75
4	FV tubo betoni ϕ 400mm	ml	5.00	2.21	11.05
5	Preje bime te vogla deri ϕ 10 cm (360	m2	1260	0.08	100.80
6	F.Vendosje pllaka betoni C16/20(1:2) pa llac(40x50x5) cm	m2	310	0.36	111.60
7	F.Vendosje pllaka betoni C16/20(1:2) pa llac(30x50x5) cm	m2	930	0.35	325.50
8	Strukture monolit betoni C16/20(Fuga 0.05*0.03 + brez betoni 0.05x0.1)	m3	16.9	12.80	216.32
9	Struktura te holla monolit betoni C16/20 (qafore + fashete betoni e tobinove)	m3	20.97	12.80	268.42
10	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	327		
11	FV tubo plastike ϕ 200mm	ml	20	0.60	12.00
12	FV tubo plastike ϕ 150mm	ml	15	0.50	7.50
Ore pune ne total per kryerjen e		Referuar Normatives sipas Mar			3243
Dite pune 8 orarshe ne total		ore pune total/ 8 ore ne dite			405
Periudha ne dite per kryerjen e		26 dite pune / muaj * 1 muaj			26
Numri i fuqise punetore per kryerjen e punimeve per 1 muaj		405 dite pune total /39			16
Gjithsej fuqia punetore e nevojshme per realizimin e kontrates					16
2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë te punësuar si staf teknik					
Inxhinier Hidroteknik 1(një)					
Specialist Ndërtimi 2 (dy)					
Pllakashtrues 7 (shtatë)					
Punëtorë 5 (pese)					
Manovrator 2 (dy)					
Hidraulik 1(një)					
Elektriciist 1(një)					
Drejtuës Mjeti 2 (dy)					

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.8 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr.	Lloji i mjetit	Njesia	Sasia	Statusi
1	Autoveteshkarkuese 7 deri 10 ton	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
2	Betoniere	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
3	Eskavator me goma 0.25m ³	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
4	Eskavator krahegjate me zingjir,	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
5	Vibrator thellesie	Cope	2	Ne pronesi ose me qira
6	Autovinc 50 KN 1	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
7	Tokmak Elektrik	Cope	6	Ne pronesi ose me qira
8	Buldozer S-80/100 KF (kuaj/fuqi)	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
9	Rul (cilinder) me dhembe	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
10	Pompe moto-5KF (kuaj/fuqi)	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
11	Motosaldatrice	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
12	Gazogjen 1m ³ /ore	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
13	Elektrosaldatrice	Cope	1	Ne pronesi ose me qira

- a) Për mjetet që regjistrohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetëm mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumentet e mesiperme duhet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerve është

përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara në pronësi ose me qira.

Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatë vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (Sistemi I menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (Sistemi I menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020 të ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikatë, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë..

ISO 9001:2015 – ose ekuivalent Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi ”Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

-
- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.
 - synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate të 2008 ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se Oe ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

ISO 14001:2015 –ose ekuivalent Sikurse vëren edhe VNM e pregatitur nga projektuesi, zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të pregatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose të përditësuar) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

ISO 45001 : 2018 - ose ekuivalent Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, Ak duhet të sigurohet se Oe zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës

Certifikata **ISO 45001 : 2018** dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, termat e references, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve janë pjesë e DT.

Njesia e Prokurimit: